


474



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 213, datë 13.12.2023

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR.17,
DATË 20.2.2023, TË KRYEMINISTRIT, "PËR KRIJIMIN E GRUPIT
NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN
E PROPOZIMEVE LIGJORE PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË
SË SHËRBIMEVE PUBLIKE QË OFROHEN NGA NJËSITË
E VETËQEVERISJES VENDORE, NËPËRMJET SISTEMIT
TË MATJES SË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE PUBLIKE"**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËR O J:

I. Në urdhrin nr.17, datë 20.2.2023, të Kryeministrit, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të ketë në përbërje përfaqësuesit e mëposhtëm:

- Zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës për financat vendore;
- Zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjës për mbrojtjen sociale;
- Zëvendësministrin e Arsimit dhe Sportit, përgjegjës për arsimin parauniversitar;

- Zëvendësministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, përgjegjës për infrastrukturën;
- Zëvendësministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për infrastrukturën bujqësore në nivel vendor;
- Zëvendësministrin e Kulturës, përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- Drejtorin e Kabinetit të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Drejtorin e Kabinetit të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Krijimin e grupit teknik të punës për identifikimin e ndërhyrjeve për shërbimet publike, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të tyre, i cili të drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe të ketë në përbërje përfaqësues, në nivel drejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, në pozicione që lidhen me çështjet e pushtetit vendor nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Kulturës;
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- Shoqata e Përfaqësuesve të Vetëqeverisjes Vendore;
- Shoqata e Qarqeve.”.

4. Pika 5 shfuqizohet.

5. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Grupi ndërinstytucional i punës është përgjegjës për:

- a) miratimin e nevojave për ndryshime, shtesa ose akte normative të reja, bazuar në një analizë të politikave shtetërore dhe të legjislacionit sektorial, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike dhe i paraqet pranë ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor;
- b) vlerësimin dhe finalizimin e dokumenteve dhe raporteve të përgatitura nga grupi teknik i punës në kuadër të detyrave të përcaktuara sipas këtij urdhri dhe i paraqet pranë ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor;
- c) koordinimin e punës me grupin teknik të punës, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij urdhri.”.

6. Pas pikës 6 shtohet pika 6.1, me këtë përmbajtje:

“6.1. Grupi teknik i punës është përgjegjës për:

- a) identifikimin e ndërhyrjeve për shërbimet publike me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të tyre, propozimin e treguesve për matjen e performancës dhe metodologjisë për vendosjen e sistemit të administrimit të performancës nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë si një nga çështjet e metodologjisë dhe mekanizmin e incentivave financiare, brenda 8 (tetë) muajve nga miratimi i këtij urdhri;
- b) hartimin e relacioneve ose raporteve për analizën e kryer dhe propozimin e masave të tjera të nevojshme për vendosjen e sistemit të matjes së performancës së shërbimeve nga ana e njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe, duke bashkërenduar punën me grupin ndërinstytucional të punës, i paraqet pranë ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, brenda datës 31 dhjetor 2024;
- c) kryerjen e çdo detyre tjetër që caktohet nga kryetari i grupit teknik të punës, në funksion të arritjes së qëllimit të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucionit që përfaqësojnë anëtarët e grupit teknik të punës.”.

7. Në pikën 11, fjalët “... në pikën 2 ...” dhe “... sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme ...” zëvendësohen përkatësisht me “... në pikat 2 dhe 3 ...,” dhe “... ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor ...”.

II. Ngarkohen grupi ndërinstitucional i punës, grupi teknik i punës dhe sekretariati teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

A large, stylized handwritten signature in black ink is written over the printed name 'EDI RAMA'. The signature consists of several sweeping, interconnected lines that form a complex, abstract shape, characteristic of Edi Rama's signature.

NR.PROT.5494/1
DATE 14.12.2023

MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERJISË
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
MINISTRIT TË SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË DREJTËSISË
AGJENCISË SHËTETËRORE TË PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS
AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA
AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
SHOQATËS SË PËRFAQËSUESVE TË VETËQEVERISJE VENDORE
SHOQATËS SË QARQEVE
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

